



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:120576
Datë: 17.12.2020
Numri i dokumentit: 01350193

C.nr.11/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Florije Qerimi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike të paditëses F. ...- Kosovë, - Prishtinë, ndaj të paditurve B.dhe E. A.– Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti pagim i borxhit nga Kontrata për Huan Individuale, vlera e kontestit 1,147.60 €, jashtë seancës gjyqësore më datën 10.12.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË MOSBINDJES

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses F. ...- Kosovë, me seli në Prishtinë dhe DETYROHEN të paditurit B. A dhe E. A të përmbushin ndaj paditëses obligimin në shumën prej 1,147.60 €, si dhe kamatën ligjore prej 8 % duke filluar nga data 24.12.2018 e deri ne pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë më datën 24.12.2018, ka paraqitur padi kundër të paditurve, për pagimin-kthimin e borxhit në shumën prej 1,147.60 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 24.12.2018, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sipas pretendimeve të paditëses, të paditurit nuk i kanë përmbushur detyrimet e pagesës së borxhit nga Kontrata e Huas Individuale më datë 29.06.2016 edhe përkundër vërejtjes nga pala paditëse më datë 13.12.2016 për përmbushjen e këtij detyrimi dhe i ka propozuar gjykatës që pas adminsitrimit të provave ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin C.nr.11/2019, të datës 07.02.2019 të cilin të paditurit e kanë pranuar

personalisht më datë 21.02.2019 përkatësisht më datë 26.02.2019, (të cilat data janë konfirmuar në fletëkthesat të cilat gjenden në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata i ka njoftuar të paditurit për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i kenë të njëjtit nëse nuk paraqesin përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tyre.

Të paditurit, pavarësisht se e kanë pranuar personalisht aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk kanë paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK-së, në të cilën dispozitë shprehimisht parashihet se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.”*

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë e ka vërtetuar faktin se të paditurit me paditësen me datën 29/06/2016 kanë nënshkruar Kontratën mbi Huanë Individuale në shumë prej 1,000 €, me detyrimin që obligimi për kthimin e huasë ka qenë i përcaktuar deri me dt.05.07.2018, ku të paditurit nuk i janë përmbajtur për huanë duke mos ju paguar borxhin ndaj paditëses edhe për kundër faktit se paditësja me dt.13.12.2016 i ka dërguar dy vërejtje me shkrim për pagimin e borxhit sipas kontratës së lartëcekur duke paralajmëruar për pasojat e mospërmbushjes.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 150 i LPK-së, e në lidhje me dispozitat nga neni 245, paragrafi 1 LMD-së i Republikës së Kosovës, ..., ku përcaktohet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë ate me ndëgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, andaj në rastin konkret gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Andaj, nga të lartëcekurat gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi për kamatë ligjore prej 8%, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD.

Vendimi që palët e paditura në mënyrë solidare t'i bartin shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën ligjore në mbështetje të nenit 449 dhe 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet tarifës për padi në shumë prej 30 € .

Duke u bazuar në të dhënat e lartshënuara gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.11/19, me datën 10.12.2020

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimin pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.